

PROCESVERBAL
Nga seanca e 29-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
të mbajtur me datë 6.9.2023

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Llazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, mr. Arben Saiti, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë : /

Z. Petrushevski e hapi seancën e 29-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 14:05 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota “pro”, miratoi:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga vazhdimi i parë i seancës së 27-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur me datë 29.8.2023.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 6-të Publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur me datë 29.8.2023.
3. Miratimi i Propozim-Procesverbalit të seancës së 28-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur me datë 29.8.2023.
4. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të operatorit Altra-sat 2000 nga Ohri, për shkëlqje të nenit 141 të LSHMAAV.
5. Propozim-aktvendim për fshirje nga regjistri i transmetuesve të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI POLOG SHPKNJP Tetovë.
6. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe miratoi njëzëri Procesverbalin e propozuar nga vazhdimi i parë i seancës së 27-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur me datë 29.8.2023, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe miratoi njëzëri Procesverbalin e propozuar të seancës së 6-të Publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur me datë 29.8.2023, me tekstin e propozuar.

Pika 3

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe miratoi njëzëri Procesverbalin e propozuar të seancës së 28-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur me datë 29.8.2023, me tekstin e propozuar.

Pika 4

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të operatorit Altra-sat 2000 nga Ohri, për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV. Ai ka shpjeguar se nga mbikëqyrja është konstatuar se transmetuesi është duke ritransmetuar shërbimin programor “Alfa TV”, i cili nuk përfshihet me çertifikatën për regjistrim të shërbimeve programore të dhëna nga Agjencia. Ai supozon se bëhet fjalë për pakujdesi, por pavarësisht kësaj ka shkelje të nenit 141 të LSHMAAV dhe sugjeroi që të shqiptohet masë vërejtje publike dhe të udhëzohet menjëherë pas pranimit të Aktvendimit për vërejtje publike të harmonizon punën e tij me LSHMAAV.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.11-3313/1, datë 31.8.2023 dhe njëzëri konstatoi operatorit të rrejtit publik të komunikimit elektronik Shoqëria Tregtare për prodhim, tregti dhe shërbime ALTRA- SAT 2000 SHPKNJP Ohër t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV dhe në pajtim me pikën 8 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndëmmarrjen e masës (Tekst i pastruar) nr.01-4139/1 të datës 7.11.2022 e ka udhëzuar menjëherë pas pranimit të Akvendimit për vërejtje publike që të harmonizojë punën e tij me LSHMAAV.

Me mbikëqyrje është konstatuar se Shoqëria Tregtare për Prodhim, Tregti dhe Shërbime ALTRA-SAT 2000 SHPKNJP Ohër, e cila sipas njoftimit nga Agjencia për Komunikime Elektronike mund të kryej veprimtari në territorin e komunës së Ohrit, për shfrytëzuesit e tij ritransmeton shërbimin programor “Alfa TV” i cili nuk është i përfshirë me çertifikatë për regjistrim të shërbimeve programore e dhënë nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, e cila është në kundërshtim me nenin 141 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Spektori për Çështje Juridike të hartojë Akvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike operatorit në fjalë.

Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtën e autorit pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryej mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (operatori) ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e mësipërm ta publikojnë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 5

Z. Trajçevski e shpjegoi Propozim-aktvendimin për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI POLOG SHPKNJP Tetovë. Ai shpjegoi se sipas vendimit të Këshillit për heqjen e lejes të këtij transmetuesi, hapi i radhës është fshirja nga regjistri. Ky është vendim formal.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI POLOG SHPKNJP Tetovë.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e mësipërm ta publikojë në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut” dhe në ueb faqen e Agjencisë.

Pas votimit, z. Petrushevski tha se ky është një tjetër lajm i keq, sepse në vitet e fundit ka pasur disa media që kanë pushuar së ekzistuari, kryesisht për arsye financiare. Në këtë drejtim, ai tha se ka ende mjaft media në Maqedoni dhe nuk është zvogëluar mundësia për demokraci, rreth 100.

Pika 6

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

Nr. 02-3375/4

25.09.2023

Shkup

Agjencia për Shërbime Mediatike

Audio dhe Audiovizuale

Kryetari i Këshillit,

Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.